

TERMAT E REFERENCËS

Për prokurimin e shërbimeve të integruara

Projekti “Këlcyra Historike dhe Natyrore”

Autoriteti kontraktor	Objekti	Kohëzgjatja
Bashkia Këlcyrë	Marketing, platformë digjitale, guida audiovizuale dhe dy evente promovuese	9 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës

1. Autoriteti kontraktor dhe konteksti

Bashkia Këlcyrë synon të krijojë dhe promovojë një produkt të integruar turistik të mbështetur në trashëgiminë historike, kulturore dhe natyrore të territorit. Përmbajtja do të trajtojë Këlcyrën si destinacion tërësor, duke përfshirë Sarajet e Ali Bej Këlcyrës, peizazhin natyror, traditat, historinë lokale, itineraret dhe pika të tjera interesi. Kalaja Ilire do të përfshihet në masën që lejojnë burimet e verifikueshme.

Kontrata lidhet me projektin “Këlcyra Historike dhe Natyrore”, të financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), sipas dokumentacionit të projektit, Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 3595, datë 10.09.2024, marrëveshjes së investimit dhe akteve të tjera përkatëse.

Shërbimet përfshijnë Aktivitetin 7 (kode QR dhe guida audio/video), Aktivitetin 8 (plan marketingu, faqe interneti, rrjete sociale dhe promovim online) dhe Aktivitetin 9 (organizimi i dy eventeve).

2. Objekti dhe qëllimi i kontratës

Objekti është angazhimi i një operatori ekonomik për konceptimin, prodhimin, zbatimin dhe dorëzimin e një pakete të integruar promovimi turistik.

- hartimin e planit të marketingut dhe identitetit të komunikimit;
- zhvillimin e faqes së internetit dhe pranisë digjitale;
- prodhimin e guidave audio/video dhe aktivizimin e tyre me kode QR;
- organizimin e dy eventeve kulturore-promovuese;
- matjen e rezultateve, raportimin dhe transferimin e plotë të produkteve të Bashkia Këlcyrë.

3. Subjekti i pranueshëm

Operatori ekonomik mund të jetë person fizik ose person juridik, i regjistruar dhe aktiv sipas legjislacionit në fuqi, me objekt veprimtarie dhe kapacitete të përshtatshme për shërbimet e kërkuara.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë ose mbështetjeje në kapacitetet e subjekteve të tjera, zbatohen kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik dhe të dokumenteve standarde të tenderit. Asnjë formulim në këto terma reference nuk duhet të interpretohet si kufizim vetëm për një formë

juridike, përveçse kur kjo kërkohet dhe argumentohet shprehimisht nga legjislacioni ose marrëveshja e financimit.

Nuk kërkohet një formë e veçantë organizimi, numër minimal punonjësish apo strukturë e përhershme e dedikuar. Kapacitetet mund të përmbushen nga vetë operatori, nga ekspertë të deklaruar, bashkëpunëtorë ose nënkontraktorë, sipas mënyrave të lejuara nga legjislacioni dhe dokumentet e tenderit.

4. Fusha e shërbimeve dhe produktet e kërkuara

4.1 Plani i marketingut dhe promovimi online

- analizë e audiencave, tregut, konkurrencës dhe kanaleve të komunikimit;
- pozicionim, mesazhe kryesore, identitet vizual i fushatës dhe udhëzues i shkurtër përdorimi;
- plan 9-mujor marketingu me objektiva, kalendar, përgjegjësi, buxhet indikativ dhe tregues performance;
- minimumi 24 publikime grafike/fotografike dhe 8 video të shkurtra për rrjetet sociale;
- minimumi 2 fushata promovimi me pagesë; buxheti i reklamimit të paraqitet si zë më vete në ofertë;
- raport analitik mbi shtrirjen, angazhimin, klikimet dhe rezultatet e fushatave.

4.2 Faqja e internetit

- faqe dygjuhëshe, në shqip dhe anglisht, e përshtatshme për celular, tablet dhe desktop;
- seksione për Këlcyrën si destinacion, Sarajet, trashëgiminë natyrore dhe kulturore, itineraret, guidat, eventet, galerinë, kontaktet dhe informacionin praktik;
- integrim të kodeve QR, hartës, materialeve audio/video dhe statistikave të përdorimit;
- CMS për përditësim nga Bashkia, optimizim bazë SEO, certifikatë SSL, kopje rezervë dhe masa bazë sigurie;
- regjistrim/konfigurim domain-i dhe hostim për të paktën 12 muaj pas pranimi përfundimtar;
- trajnim praktik për të paktën dy punonjës dhe manual përdorimi;
- garanci korigjuese dhe mirëmbajtje teknike për 12 muaj pas pranimi.

4.3 Guida audio/video dhe kode QR

- dy video kryesore, nga 5–8 minuta secila, me tematika të përcaktuara pas kërkimit fillestar;
- videoja e parë do të trajtojë Sarajet e Ali Bej Këlcyrës dhe lidhjen e tyre me historinë e zonës;
- videoja e dytë do të prezantojë Këlcyrën në mënyrë më të gjerë: peizazhin natyror, historinë, traditat, itineraret dhe pikat e interesit; Kalaja Ilire mund të përfshihet si pjesë e kësaj narrative, sipas informacionit të dokumentuar;
- minimumi dy guida audio tematike, nga 4–7 minuta secila; temat dhe pikat e dëgjimit përcaktohen në bazë të materialit të disponueshëm dhe përvojës së propozuar për vizitorin;
- versione në shqip dhe anglisht; videot të kenë titra në të dyja gjuhët;
- rezolucion minimal Full HD 1080p, format MP4; audio e masterizuar në format WAV dhe MP3;
- përdorim vetëm të materialeve me të drejta të rregulluara dhe citim të burimeve historike; hipotezat, gojëdhënat dhe informacionet e pakonfirmuara duhet të dallohen qartë nga faktet e dokumentuara;
- kode QR funksionale për materialet e prodhuara dhe pikat e përzgjedhura, të testuara, me skedarë vektorë dhe versione për printim;

- dorëzim të materialeve finale dhe skedarëve burimorë/editues.

4.4 Organizimi i dy eventeve promovuese

Eventi 1 – Art dhe folklor lokal:

- program me muzikë, valle, artizanat dhe prezantim të traditave vendore;
- angazhim të artistëve, grupeve folklorike, artizanëve dhe komunitetit lokal.

Eventi 2 – Histori dhe kulturë:

- prezantime nga historianë/ekspertë, guida të drejtpërdrejta dhe elemente skenike, dokumentare ose dramatike;
- trajtim të historisë së Këlcyrës, figurave dhe rolit të zonës në rajon.

Për secilin event operatori duhet të sigurojë:

- koncept, program, skenar, kalendar dhe buxhet;
- organizim për një kohëzgjatje minimale prej 2 orësh dhe kapacitet planifikimi për të paktën 50 pjesëmarrës;
- artistë/folës, moderim, zë, ndriçim, energji rezervë, skenografi bazë dhe personel teknik;
- leje, siguri, pastrim, menaxhim të mbetjeve dhe plan rezervë për kushtet atmosferike;
- promovim paraprak, marrëdhënie me median, sinjalistikë, fotografim dhe video-dokumentim;
- raport pas aktivitetit me programin, pjesëmarrjen, mbulimin mediatik dhe evidencat.

5. Produktet, afatet dhe kriteret e pranimit

Kodi	Produkti	Afati maksimal	Kriteri kryesor i pranimit
D1	Raporti fillestar, metodologjia dhe plani i punës	15 ditë	Miratim me shkrim ose email nga Bashkia
D2	Plani i marketingut, identiteti dhe kalendar editorial	Fundi i muajit 2	Përmbajtje e plotë, e zbatueshme dhe me KPI
D3	Faqja dygjuhëshe funksionale dhe trajnimi	Fundi i muajit 4	Testim teknik, siguri, CMS dhe akses nga pajisje të ndryshme
D4	2 video tematike, minimumi 2 guida audio, titra dhe kode QR	Fundi i muajit 6	Përputhje teknike e gjuhësore; burime të dokumentuara dhe dallim i qartë mes fakteve e hipotezave
D5	Eventi i parë dhe raporti i tij	Muaji 7–8	Realizim sipas programit të miratuar dhe evidenca
D6	Eventi i dytë dhe raporti i tij	Muaji 8–9	Realizim sipas programit të miratuar dhe evidenca
D7	Raporti përfundimtar dhe arkiva e plotë	Brenda 10 ditëve nga eventit i fundit	Pranim i të gjitha skedarëve finalë/burimorë dhe transferim njohurish

Për çdo produkt parashikohen deri në dy raunde të konsoliduara komentesh, pa kosto shtesë. Bashkia shqyrton produktin brenda 10 ditëve pune; operatori korrigjon mangësitë brenda 5 ditëve pune, përveç rasteve kur palët miratojnë një afat tjetër.

6. Kohëzgjatja dhe vendi i zbatimit

Kohëzgjatja efektive e kontratës është 9 muaj nga data e hyrjes në fuqi, brenda afatit të përgjithshëm të projektit. Aktivitetet do të zhvillohen kryesisht në territorin e Bashkisë Këlcyrë, ndërsa prodhimi, koordinimi dhe shërbimet digjitale mund të realizohen edhe në distancë sipas planit të miratuar.

7. Organizimi, stafi dhe kualifikimet

Operatori propozon mënyrën e organizimit dhe ndarjen e roleve. Drejtuesi i kontratës mund të jetë vetë operatori ekonomik dhe mund të realizojë drejtpërdrejt komponentët e komunikimit, web-it dhe multimedias. Nuk kërkohet që specialistët mbështetës të jenë punonjës të përhershëm. Ata mund të angazhohen si ekspertë të deklaruar, bashkëpunëtorë ose nënkontraktorë, sipas legjislacionit dhe dokumenteve të tenderit.

I njëjti person mund të mbulojë më shumë se një funksion kur provon kapacitetin përkatës dhe kur kjo nuk cenon cilësinë, pavarësinë e funksioneve ose afatet.

Funksionet e përkthimit, narracionit, prodhimit teknik, fotografisë, sigurisë dhe angazhimit artistik mund të mbulohen me bashkëpunëtorë ose ofrues të specializuar.

8. Raportimi dhe monitorimi

- raport fillestar dhe plan pune;
- raport specifik pas secilit event;
- raport përfundimtar me rezultatet kundrejt KPI-ve, mësimet dhe rekomandimet;
- takime koordinimi të paktën një herë në muaj dhe sa herë kërkohet për miratimet kryesore.

9. Struktura e pagesave

Kësti	Pesha	Kushti i pagesës
1	20%	Paradhënie për mobilizim, pas hyrjes në fuqi të kontratës
2	40%	Pas pranimit të D1-D4: planifikimi, marketingu, faqja, videot, guidat audio dhe kodet QR
3	40%	Pas realizimit dhe pranimit të D5-D7: dy eventet, raportet dhe arkiva përfundimtare

Paradhënia është pjesë e çmimit total të kontratës dhe përdoret për kostot fillestare të mobilizimit, kërkimit, prodhimit dhe organizimit.

Dy pagesat e tjera kryhen vetëm pas dorëzimit, verifikimit dhe pranimit me shkrim të produkteve përkatëse. Paradhënia, mënyra e amortizimit dhe afatet e pagesës duhet të pasqyrohen në kushtet e veçanta të kontratës dhe të konfirmohen paraprakisht nga strukturat e financës/prokurimit dhe nga FSHZH, sipas marrëveshjes së financimit.

10. Pronësia intelektuale dhe mbrojtja e të dhënave

- Pas pagesës dhe pranimit, të gjitha të drejtat pasurore mbi produktet e krijuara posaçërisht për kontratën i transferohen Bashkisë Këlcyrë, pa kufizim kohe ose territori, në masën e lejuar nga ligji.
- Operatori dorëzon skedarët burimorë/editues, kredencialet, kodin, bazat e të dhënave, materialet grafike dhe dokumentacionin teknik.
- Operatori garanton se muzika, fotografitë, videot, fontet dhe materialet e palëve të treta përdoren me licenca të vlefshme dhe dorëzon provat përkatëse.
- Publikimi i imazhit ose zërit të personave bëhet me pëlqimet/autorizimet e nevojshme, veçanërisht për të miturit.
- Të dhënat personale përpunohen vetëm për qëllimin e kontratës dhe sipas legjislacionit në fuqi.

11. Baza ligjore

Procedura e prokurimit dhe zbatimi i kontratës do të kryhen në përputhje me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; dokumentet standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik; si dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm.

Kur marrëveshja e financimit ose aktet e FSHZH-së parashikojnë kërkesa plotësuese, ato harmonizohen me dokumentet e procedurës nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë.